

Shtojca 12.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

16.12.2025

Drejtuar : OE “Gjeokonsult & CO” shpk, me NIPT K91810005U, me adresë: Tiranë Njesia Administrative Nr. 05, Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 45, Shkalla 01, Kati i pare, Zona Kadastrale 8270, Pasuria Nr. 4/146-N9, me pikë 300.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Shërbime

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar

Numri i Procedurës / referencia e Lotit: **LOTI 1: REF-67373-10-31-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **LOTI 1 Me Objekt:** “Projektimi i Infrastrukturës së Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, zona e Mbetjeve Fier”.

Fondi Limit LOTI 1: **32,060,095.89** (tridhjetë e dy milion e gjashtëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Fondi Limit në Euro për LOTIN 1: Konvertuar sipas kursit të këmbimit nga Banka e Shqipërisë me datë 30.10.2025 është 330,789.27 Euro.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 03.11.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Buletini Nr. 69 datë 10 Nëntor 2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto X
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE: “I.Frantzis and Associates” LTD shpk

NIPT EL095619090

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

&

“GR ALBANIA” shpk

NIPT L01509004N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

&

“LEAD CONSULTING” shpk

NIPT L82322016N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 26,900,000 (njetëzet e gjashtë milion e nentëqindë mijë) lekë pa tvsh;
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. OE: “Gjeokonsult & CO” shpk

NIPT K91810005U

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 28,682,885.72 (Njetëzet e tete milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e teteqind e tetëdhjetë e pesë pik shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh, me pikë 300.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **BOE: “I.Frantzis and Associates” LTD shpk**

NIPT EL095619090

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t arsytet e mëposhtme

&

“GR ALBANIA” shpk

NIPT L01509004N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t arsytet e mëposhtme

&

“LEAD CONSULTING” shpk

NIPT L82322016N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t arsytet e mëposhtme

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Për arsye se:

BOE “I.Frantzis and Associates” LTD me nr. nipti EL095619090 & “GR ALBANIA” shpk me nr. nipti L01509004N & “LEAD CONSULTING” shpk me nr. nipti L82322016N, skualifikohet pasi me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

- *Oferta ekonomike e paraqitur nga BOE është poshtë vlerës minimale të lejuar, kjo në kundërshtim me VKM nr.354/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe rekomandimin nr. 5585, datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik.*
- *Anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “GR ALBANIA” shpk nuk plotëson piken 2.2.2, në të cilën është kërkuar: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik*

duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të balanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të një pasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, I ndryshuar. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë kapital të pakten 20% të vlerës së perlllogaritur të kontratës”

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesi për përmbushjen e këtij kriteri në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “GR ALBANIA” shpk ka paraqitur kopje të çertifikuara të balanceve për vitet financiare 2022, 2023 por nuk ka paraqitur bilancin për vitin financiar 2024.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

- BOE nuk plotëson piken 2.3.4, në të cilën është kërkuar: “Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV ku të kenë të paktën 10 vite eksperiencë, diplomë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Koordinator projekti)
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport)
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikatë VNM
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Gjeofizik
- 1 (një) Arkitekt

Drejtuesit teknik si më sipër duhet të jenë të punësuar pranë shoqërisë dhe të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të vendimit nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit

Nga verifikimi i Formularëve Permblledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik, Seksioni B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” rezulton se për kriterin e disponimit të 1 (një) Inxhinier Mjedisi i pajisur me certifikate VNM, ofertuesit kanë deklaruar punonjesen: D.K (punonjese e operatorit ekonomik “GR ALBANIA” shpk. Nga verifikimi i Licences N.6705/15 “Në projektim” së operatorit ekonomik “GR ALBANIA” shpk, rezulton se punonjesja D.K nuk është e përfshirë në licensën e shoqërisë si drejtues teknik duke mos përmbushur kushtin e kerkuar në kriterin 2.3.4.

- *BOE nuk plotëson pikën 1, shkronjën “a” të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi nuk kanë paraqitur “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” sipas shtojcës 10, të miratuar me Vendimin nr. 10, datë 23.09.2024 “Per miratimin e dokumentave standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “E hapur-Shërbime”. Në rastin konkret të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik kanë përdorur një formular vetëdeklarimi të ndryshëm nga ai i publikuar nga autoriteti kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit ku mungojnë krejtësisht deklaratimet e detyrueshme:*

Vetëdeklarimi se Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Vetëdeklarimi se Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi,

*si dhe **Seksioni B: Deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura** i plotësuar nga operatori ekonomik është i ndryshëm nga formulari i vetëdeklarimit i publikuar nga autoriteti kontraktor.*

- *Anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “I.Frantzis and Associates” LTD, nuk rezultoi i regjistruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik në përputhje me Vendim Nr. 13 datë 28.12.2021 “Per miratimin e manualit për regjistrimin e Operatoreve Ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “Gjeokonsult & CO” shpk, me NIPT K91810005U, me adresë: Tiranë Njesia Administrative Nr. 05, Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 45, Shkalla 01, Kati i parë, Zona Kadastrale 8270, Pasuria Nr. 4/146-N9, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 28,682,885.72 (Njezete e tete milion e gjashteqind e tetedhete e dy mije e teteqind e tetedhete e pese pik shtatedhete e dy) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra 300 është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

